



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-124

Prishtinë, më 11 shtator 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, Kabineti i kryetarit të Kuvendit

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 SHTATOR 2013

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi dhe Shaban Selimi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit për vizitën e kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, që do ta ketë këto ditë në Republikën e Kosovës.

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, gjatë kësaj vizite, ka shprehur interesimin që me një fjalë rasti t'u drejtohet edhe deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, vendosi që Kuvendi, më 13 shator 2013, në orën 12:00, të mbajë seancë solemne, me këtë

### **Rend dite**

Adresimi i kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:15.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*